



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 840/13 prot.

Pogradec, më 25.02, 2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Znj. Manjola Kamolli
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin:

“MBËSHTETJE FINANCIARE PËR STUDENTIN REDI YZELLARI”

Me respekt,

KRYETARI

Hir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1 (një)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (dy)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E TURIZMIT, TRASHËGIMISË KULTURORE DHE RINISË

Nr. 890/13 Prot.

Pogradec, më 25.02 . 2026

RELACION

PËR

Mbështetjen financiare për studentin Redi Yzellari për pjesëmarrje në Olimpiadën e 20-të Ballkanike Studentore Matematike që zhvillohet ne Pafos të Qipros.

Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë duke u bazuar në Kërkesën dhe Letrën Vlerësuese të Prof. Asoc. Dr. Rafail Prodani Dekan i Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane Universiteti "Fan S. Noli" Korçë lidhur me studentin Redi Yzellari për mbështetje financiare nga ana e Bashkisë Pogradec për pjesëmarrje në Olimpiadën e 20-të Ballkanike Studentore Matematike (**20th South Eastern European Mathematical Olympiad for University Students, SEEMOUS 2026**), që zhvillohet ne **Pafos të Qipros** kërkon aprovimin e këtij propozimi.

Redi Yzellari është student i vitit të dytë në programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Informatike", program i përbashkët me Universitetin Politeknik të Tiranës. Ai është dalluar për rezultate të shkëlqyera akademike, përkushtim të lartë ndaj studimeve dhe angazhim serioz në aktivitetet mësimore dhe praktike të programit.

Gjatë dy viteve të para të studimit, Redi ka demonstruar aftësi të forta analitike, kompetencë teknike në fushën e programimit dhe sistemeve informatike, si dhe një etikë pune shembullore. Ai përfaqëson profilin e një studenti me potencial të lartë për zhvillim profesional në fushën e



teknologjisë së informacionit, një sektor me rëndësi strategjike për zhvillimin lokal dhe kombëtar.

Duke vlerësuar rezultatet e shkëlqyera të studentit Redi Yzellari mendojmë se e meriton plotësisht këtë mbështetje.

Konceptoi: L. Beqari

Miratoi: L. Zeqollari

Konfirmoi: E. Gushe

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ . 2026

PROJEKT-VENDIM

NR. _____, DATË ____ . ____ . 2026

MBËSHTETJE FINANCIARE PËR STUDENTIN REDI YZELLARI

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor te Republikes te Shqiperise", i ndryshuar, Udhezimit te Ministrise se Financave nr. 2, date 14.01.2026 , "Per zbatimin e buxhetit 2026 , VKB 128 dt 22.12.2025 "Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026 " Këshilli Bashkiak :

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare në masën 65 000 gjashtëdhjetë e pesë mijë lekë nga buxheti i Bashkisë , në favor të studentit Redi Yzellari për pjesëmarrje në Olimpiadën e 20-të Ballkanike-Studentore Matematike që zhvillohet ne Pafos të Qipros.
2. Ky fond përballohet nga fondi rezervë i parashikuar në Buxhetin e Bashkisë Pogradec për vitin 2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administrimit të Cështjeve Ekonomike dhe Financiare.
4. Vendimi të hyjë në fuqi menjëherë mbas lajmërimit të individit.

KRYETARE

MANJOLA KAMOLLI